



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORE  
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS  
NR. 931 PROT.  
DATA 16.04.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 15 Prot.

Vlorë, më 16.04.2024

VENDIM

Nr. 04, datë 16.04.2024

PËR

HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR REKTOR DHE  
ANËTAR TË SENATIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI"  
VLORE

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në mbështetje të nenit 25 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë", miratuar me Vendimin nr. 11 të Senatit Akademik, datë 21.3.2024, Komisioni Institucional Zgjedhor, në mbledhjen e datës 16.04.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Rektor dhe Anëtar të Senatit Akademik në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve datën 7.5.2024, deri në datën 13.5.2024, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.
3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht në zyrën e Komisionit Institucional Zgjedhor për të depozituar dokumentacionin për kandidim. Pas regjistrimit, kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat nga Komisioni Institucional Zgjedhor.
4. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR  
OLJANA HOXHAJ

ANËTARËT

LORENA ÇAKËRRI  
SONILA NIKA  
ROZANA LIKO  
BIANKA KANANAJ

Adresa/Address: Lagjja "Pavarësia", Rruga "Kosova", 9400 Vlorë, Shqipëri  
Tel: ++355 222 288 Eeb-site: [eeë.univlora.edu.al](http://eeë.univlora.edu.al) e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORE  
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS  
NR. 931/11 PROT.  
DATA 16.04.2024

Nr. 16 Prot.

Vlorë, më 16.04.2024

**NJOFTIM**

**PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR REKTOR  
DHE ANËTAR TË SENATIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI"  
VLORE**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në mbështetje të nenit 25 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë", miratuar me Vendimin nr. 11 të Senatit Akademik, datë 21.3.2024, Vendimit të Komisionit Institucional Zgjedhor Nr. 01, datë 16.04.2024 "Për hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Rektor dhe Anëtar të Senatit Akademik në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë", Komisioni Institucional Zgjedhor, hap procesin e regjistrimit të kandidatëve për Rektor dhe Anëtar të Senatit Akademik. Kërkesa për kandidim nga personat e interesuar depozitohet nga kandidati në Sallën e Mbledhjeve të Senatit, kati i tretë, godina A, nga data 7.5.2024, deri në datën 13.5.2024, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.

**I - Kandidatët për Rektor duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:**

- a).Kërkesa për kandidim, e cila përmban emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Formularët e vetëdeklarimit, të cilët kandidati i tërheq pranë KIZ-it;
  - i.deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në RSH", si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;
  - ii.mungesen e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik;
  - iii.deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
  - iv.deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale.
  - v. deklarimin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.

**II - Kandidatët për Anëtar të Senatit Akademik duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:**

- a).Kërkesa për kandidim, e cila përmban emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit;

- c) Formularët e vetëdeklarimit, të cilët kandidati i tërheq pranë KIZ-it;
- i.deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në RSH”, si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;
- ii.mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik;
- iii.deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrjnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- iv.deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale.
- v. deklarimin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.

**III - Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik nga radhët e studentëve duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:**

- a. Kërkesën për kandidim, e cila përfshin, emrin atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b. Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c. Vërtetimin që provon se është student me kohë të plotë në një nga njësitë kryesore të UV-së;
- d. Propozimin nga jo më pak se 30 (tridhjetë) studentë, pjesë e trupës zgjedhore, sipas standardeve të parashikuara në Rregullore, të cilët krahas emrit, mbiemrit dhe nënshkrimit, vendosin në shkresën e propozimit edhe numrin personal të kartës së identitetit.
- e. Dokumentin që vërteton mesataren e notës mbi bazën e provimeve të dhëna deri në momentin e kandidimit.

**KRYETAR I KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR  
OLJANA HOXHAJ**

**ANËTARËT**

**LORENA ÇAKËRRI**  
**SONILA NIKA**  
**ROZANA LIKO**  
**BIANKA KANANAJ**